

ZANA TAKO

**ADOLESHENCA**

QË MUND TË KAPËRCEJË ÇDO PARASHIKIM NJERËZOR

---

BOTIMET TOENA



ZANA TAKO

ADOLESHENCA  
QË MUND TË KAPËRCEJË  
ÇDO PARASHIKIM NJERËZOR

BOTIMET TOENA

Tiranë

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktore: Besa Vila

Korrektore letrare *dhe* përkujdesja grafike: Edona Marku

Kopertina: Mirjana Madhi

ISBN 978-9928-376-35-0

© Autorja

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjete apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

**BOTIMET TOENA**

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: [botimet.toena@gmail.com](mailto:botimet.toena@gmail.com)

[toena.porosionline@gmail.com](mailto:toena.porosionline@gmail.com)

[www.toena.al](http://www.toena.al)

## PASQYRA E LËNDËS

Parathënie.....	7
Stadi i adoleshencës.....	9
Komunikimi me adoleshentët.....	15
Analiza e sjelljes si domosdoshmëri.....	17
Problematikat e adoleshentëve.....	20
Efekti i psikologut tek adoleshentët.....	23
Bashkëveprimi me adoleshentët.....	26
Bota shpirtërore e adoleshentëve.....	29
Pasojat e lëndimit të adoleshentit nga mësuesi.....	33
Marrëdhëniet prind-fëmijë.....	36
Të mirat dhe dëmet e teknologjisë.....	40
Dashuria është arma që fiton çdo betejë.....	48
Ta mësojmë fëmijën me rregulla dhe me dashuri pa interes.....	52
Personaliteti i adoleshentëve.....	60
Domosdoshmëria e kërkesës për dije - çelësi i suksesit.....	63
Të luftosh unin sa më shpejt të jetë e mundur.....	66
Stimulimi i edukimit dhe miqve të mirë të fëmija.....	70

Nuk duhet të jemi imponues, por bashkëpunues.....	73
Koordinimi i dëshirave prind-fëmijë.....	76
Konsideroje fëmijën edhe shok.....	79
Të rrisim kulturën për përgatitjen shpirtërore të adoleshentit.....	83
Aleat i dëshirës është ndjenja, ndërsa i ndjenjës mendimi.....	86
T’i ruajmë adoleshentët nga rreziqet e moshës.....	89
Të rrisësh një vajzë adoleshente është bukur.....	92
Gjithçka trashëgohet, por jo gjithçka përfitohet.....	96
Personalizimi është defekt i mendimit inovativ.....	100
Indiferenca luftohet me bashkëpunim gjithëpërfshirës.....	103
Konsolidimi i marrëdhënies arsyetim-detyrë.....	112
Problemet duhet të zgjidhen në kohë.....	116
Të zgjedhim më të mirën për ne dhe fëmijët tanë.....	119

## PARATHËNIE

Të shkruash për adoleshentët duhet të depërtosh brenda shpirtit të tyre njerëzor, të prekësh fjalët që u dalin nga shpirti, t'u kuptosh buzëqeshjen, të ndiesh lotin që shket fshehurazi tek lë gjurmën e fajit apo të pafajësisë, të mos e ndërpresësh melodinë, që gurgullon brenda hovit rinor të vashës apo djalërisë. Shpirti i adoleshentit nuk është si shkëmbi, që nuk i përkulet njeriut, por është i prekshëm dhe i gjallë.

Lejojmë të rrëmbehemi brenda sipërmarrjeve të vogla të vetvetes, por nuk ndalemi edhe të kuptojmë dashurinë që e rrit këtë brez adoleshentësh, rritje që nuk është e secilit në numrin njëjës, por është e gjithsecilit në numrin shumës, e ky shumës jemi të gjithë pa dallim, prandaj duhet bashkëvepruar falë dashurisë, falë mirëqenies dhe vetëmohimit jo individualist, por gjithëpërfshirës.

Kemi ndalur në stacionin e fundit, aty ku ndahet errësira nga drita. Errësira përfshin mendje që ecin në gjurmët e paditurisë, por në dritë dallojmë embrionin e dashurisë, të cilin duhet ta ngjizim në shpirtin e krijesave që i duam aq shumë, fëmijëve tanë. Cikli i rritjes së tyre është pasqyrë ku shohim vetveten, të

pastër ose jo, të shëndetshëm apo të lig. Shëndeti i mirë është fryt i një pune të palodhur, por shpresëdhënëse për atë kohë sa fëmija rritet dhe ecën me këmbët e veta, falë dashurisë. Jemi brez ku kultivohet e tashmja dhe e ardhmja, ku në retrospektivë qartësohen ide, të cilat nuk pengohen nga ndalesa të stërzgjatura të indiferencës së padobishme. Shkallët ku ngjitet shpirti janë të padukshme, por bëhen të dukshme kur rritja e shëndetshme e fëmijës tonë, tregon se ia vlen të luftosh dhe të jetosh për frytet e ëmbla të dashurisë.

**Autorja**



## STADI I ADOLESHENCËS

Jemi mësuar të përdorim fjalën “adoleshent”, si përcaktimin e moshës së rinisë në stadin e fillimit të saj. Kemi vënë re fenomene të ndryshme, që e shoqërojnë rritjen e fëmijës tonë, të cilat edhe na gëzojnë, por edhe na shqetësojnë, ndonjëherë edhe së tepërmi. Gjithçka rrotullohet me shpejtësi, duke vënë në dukje, gjithashtu, edhe ndryshimin e mendimit, ndryshimin e sjelljes, të formulimit të frazave në të shprehur, e të gjitha këto fenomene përbëjnë atë që quhet, hyrje në zhvillimin hormonal të fëmijës tonë qoftë djalë apo vajzë. Ky ndryshim herë-herë nuk kuptohet aq sa duhet nga familjarë apo të afërm të fëmijës në rritje. Shpeshherë themi se fëmija ynë kërkon atë që nuk duhet, por nuk kuptojmë se këto kërkesa ndryshojnë humorin e fëmijës tonë ditë pas dite. Falë kërkesave ne kuptojmë edhe ndryshimin e gjendjes shpirtërore të fëmijës tonë, e cila pasqyron rrugën që po formon fëmija për bindjet e tij në jetë.

Vërejmë se kërkesat shpirtërore të tyre bien ndesh me atë çfarë ne kërkojmë prej tyre. Ky ballafaqim është sinjal që vë në dukje gjendjen ku ndodhemi, e nëse gjendemi të papërgatitur, edhe ne si prindër

jemi si ai luftëtari që niset për në betejë, prandaj njëjloj si ai duhet të armatosemi me ide të qarta, sepse tashmë kemi hyrë në një fazë të re të jetës sonë, në atë të bashkudhëtimit me fëmijën tonë në rritje. Ky bashkudhëtim ka të papriturat e veta, që nuk duhet të na trembin, përkundrazi, ka ardhur koha dhe duhet të vëmë në provë gjithçka kemi trashëguar në origjinë për një jetë brenda moralit dhe dinjitetit njerëzor.

Fenomeni i ndryshimit hormonal është faktor tepër i rëndësishëm, i cili ndikon jo rrallëherë në shpërqendrim të mendimit të sigurt dhe jo në përshtatje me atë ç'ka duhet në të vërtetë. Ndalesa të herëpashershme ndodhin gjatë ndryshimit të hormoneve dhe gjatë këtyre ndalesave çdo prind, i afërm, vëlla ose motër, duhet potencialisht të bashkëveprojnë për të dhuruar më të mirën nga vetja, fjalën më të shëndetshme në të folur, gjykimin më të shëndetshëm në të gjykuar, dhurata, të cilat e bëjnë çdo adoleshent të kapërcejë me sukses sfidat e moshës që po kalon.

Jemi shoqëri e pasur me vlera, të cilat bëhen gurë themeli për çdo vatër familjare që rrit brezin e ri, por familja e vetme nuk mund ta përballojë këtë sfidë njerëzore, sepse kusht i domosdoshëm dhe hap tepër i rëndësishëm në këtë rrugë të zhvillimit të brezit më të ri të shoqërisë sonë është bashkëveprimi, pra bashkëveprimi i mirëfilltë shoqëror. Nuk mund të kemi sukses pa këtë bashkëveprim ndërmjet familjes, shoqërisë, shkollës, punës, që do të thotë se në çdo

mjedis ku takohemi dhe bashkëndajmë fjalë, veprime, mendime, formojnë oazën e paqes shpirtërore ose e kundërta, kthimi në tranzicionin shpirtëror, që ngjan me një det shpërthyes, ku mund të mbytet edhe anija më e sofistikuar e të gjitha kohërave. Rreziqet janë të pashmangshme, por mund të bëhen të evitueshme nëse gjendemi gjithmonë në kohën e duhur dhe në vendin e duhur.

Vëmendja është produkt i mirëqenies shpirtërore. Ndodh që për shkak të mospërqendrimit në kohë, të humbim atë çka vlen më shumë, e ajo çka na vlen më shumë në jetë është fëmija ynë. Por përse e humbasim vëmendjen? Pasi trazirat e jetës, bëhen shkak kryesor dhe vendimtar që të humbasim fillin e mendimit dhe të vëmendjes. Gjithçka e pamoralshme nuk mund të quhet e moralshme, e në emër të moralit i japim vlerë antimoralit. Nuk mund të quajmë shkak dhe pasojë një bisedë pa moral në prani të fëmijës, kudo që ndodhet ai, në familje ose në qendrat e mirërritjes. Antimorali shkakton pasojë në sjelljen dhe në deformimin e mendimit të fëmijës tonë. Prezantimi i pamoralshëm në sjelljen e të rriturit ndaj një adoleshenti, lë gjurmë që nuk fshihet nga dora njerëzore. Ky hap tepër i rëndësishëm, nuk mund të korrigjohet nga vetë adoleshenti, pasi formimi i tij përpunon gjithçka në kohë rekord, e nga ky përpunim të dhënash, ai përfiton sipas humorit dhe ndjenjës në sasi të nevojës hormonale. Çdo i rritur ndaj një adoleshenti, ka përgjegjësi të theksuar

morale në bashkëveprim me të. Kjo përgjegjësi nuk mund të anashkalohet falë dëshirës, por është kusht i domosdoshëm dhe themelor i moralit njerëzor, i cili vihet në dukje nëpërmjet sjelljes së adoleshentit.

Çdo fëmijë adoleshent është qenie njerëzore që simbolizon dashurinë. Mirërritja e tyre vendos për fatin e tyre. Qëllimi nuk është kompromis kur bëhet fjalë për detyrën në mbarëvajtjen e ecures së edukimit të brezit më të ri. Jemi qenie njerëzore që bashkëndajmë dhe bashkëveprojmë me dashurinë. Ligji i dashurisë është simbol i paqes shpirtërore të gjithsecili prej nesh. E me këtë paqe, që ligjërohet në jetën e përditshme, e kemi për detyrë të ndërgjegjësohemi dhe të ndërgjegjësojmë për të vazhduar së bashku udhën e jetës.

Rastet kur fëmija adoleshent ndien pasiguri, vihen re jo vetëm nga familja, por edhe nga bashkëmoshatarët e tyre. Siç e përmendëm edhe më lart, faktori “vëmendje”, luan rol dhe funksion tepër të veçantë, pasi nëpërmjet vëmendjes kemi prekur problemin që fillon të shfaqet ditë pas dite. Nëse mungesa e vëmendjes bëhet e dukshme në kohë, atëherë njëlloj si orteku që fillon e merr përpara gjithçka gjen, ashtu edhe gjendja shpirtërore e fëmijës adoleshent fillon e luhetet si pemët në kohën e stuhisë. Kjo luhetje ndjenjash dhe mendimesh, ku vepron pasiguria, ndikon negativisht edhe në sjelljen e tij, që shfaq dukuri të kundërshtisë, të arrogancës, të papërgjegjshmërisë, herë-herë duke kaluar edhe caqet

e normalitetit njerëzor. Pasiguria nuk është simptomë sëmundjeje shpirtërore, por është dukuri që shfaqet në kohën e rritjes së mendimit adoleshent, në kohën e formimit të personalitetit të fëmijës adoleshent. Në këtë mënyrë, prindi duhet të informohet dhe të bashkëveprojë me mësues, me bashkëmoshatarë, me familjarët e vet, në mënyrë që të shkurtojë sa më shumë hendekun e marrëdhënieve ndërpersonalizuese, thënë ndryshe, fëmija adoleshent ndien nevojë për përkrahje dhe mbështetje pa e cenuar në personalitetin e tij, pa e ngatërruar origjinën e mendimit që kultivon edukatë dhe jo degjenerim.

Personaliteti i fëmijës është tipar i edukimit familjar. Në familje ruhen dhe edukohen vlera morale dhe shpirtërore prej të cilave vjelim fryte të shëndetshme ose e kundërta. Familjet me bazë moralin, ndryshojnë nga ato familje ku nuk gjenerohet vlerë në shoqëri. Thelbi i mirërritjes së fëmijës në adoleshencë është ajo çfarë trashëgojmë, e kjo trashëgimi bëhet urë ku kapërcehen të gjitha vështirësitë. Nëse vlerat e moralit edukojnë dhe rrisin fëmijë të shëndetshëm, e kundërta ndodh në ato vende ku prodhohet antimorali i shoqërisë. Të ruhesh nga e keqja është mençuri, por të bashkëpunosh me të është varfëri e mendjeve shterpë. Dallojmë në këtë përkufizim atë anë shpirtërore të njeriut që na drejton te vlera. Fëmija mëson dhe përthith në mënyrë të mrekullueshme gjithçka që e rrethon, mëson të lexojë, të shkruajë, të qeshë, të flasë, të imitojë, e shumë veprime nëpërmjet

të cilave shfaqen edhe dhuntitë e zhdërvjelltësisë së tij për prirje të veçanta. E vetmja prirje e veçantë, që e kanë të gjithë fëmijët, është sjellja. Nëse edukimi shkon drejt vlerës, nuk mund të ndodhë të prodhohet antivlerë. Por nëse i rrituri prodhon antivlerë ndaj fëmijës, atëherë edhe sjellja e tij do të reflektojë atë çfarë ai ka mësuar në përpunimin e të dhënave që merr në mënyrë të vullnetshme.

Të edukosh një fëmijë në rritje është detyrë dhe përgjegjësi për çdo prind. Të marrësh atë çfarë ke mbjellë, është fryt i punës që ke prodhuar. Shpërblimi nuk është i njëjtë për të gjithë, por është përcaktues për gjithkënd që transmeton vlerë dhe antivlerë në shoqërinë e kohëve të sotme.

## KOMUNIKIMI ME ADOLESHENTËT

Gjuha që përdorim në marrëdhënie me fëmijët adoleshentë përmban karakteristika të veçanta. Prirjet për t'u imponuar nuk mungojnë nga ana prindërore, por edhe kundërshtia nga ana e fëmijëve adoleshentë nuk mungon, kur bëhet fjalë për imponim të sjelljes prindërore. Ky komunikim i ndërsjellë krijon debate, pasi idetë dhe qëllimet mbërrijnë në gjuhë konfliktuale, vetëm atëherë kur imponimi bëhet kusht që thyen rregulla, ku mbahet fort boshti i bashkëpunimit në komunikim. Në këtë marrëdhënie nuk vjelim qartësi ndjenjash, por prodhojmë atë që nuk e duam, prandaj shijojmë atë që nuk na pëlqen. Por të zgjedhësh shpeshherë nuk është e lehtë, e në këtë rast konfliktual, prindit i duhet të zgjedhë mes heshtjes dhe debatit. Heshtja nuk është faktor që ndihmon, përkundrazi, ngatërron idetë dhe qëllimet e adoleshentit, i cili ndodhet në gjendje paqartësie. Paqartësia rritet nga forca shtypëse hormonale. Në këtë rast, prindit i duhet të ndërpresë çdo bisedë, pasi gjuha e debatit prish atë mur që është ndërtuar për t'i bërë ballë sulmit hormonal, i cili dobëson arsyen e adoleshentëve, dhe krijon kufij të rinj, që bllokojnë

mendimin e shëndetshëm të depërtojë lirshëm në gjuhën e komunikimit njerëzor.

Në adoleshencë humbasim, por edhe fitojmë. Humbja është faktor që përcakton kohën, ku fëmija lufton për të mos qenë viktimë e pasojës, por luftëtar i betejave që zhvillohen në kohën e stuhisë. Çdo i ri dhe e re, fiton shumë në këtë moshë, pasi kupton se të ndërpresësh një rrugë, që nuk të çon askund, është vendim që duhet marrë në kohën e duhur. Kjo kohë ndihmon për të hedhur hapa të sigurt drejt një qëllimi të caktuar, i cili nuk sjell zhgënjim, por fitim.

Ndihma për të vazhduar është si spiranca për anijen. Brenda kësaj anijeje gjendemi të gjithë bashkë, duke marrë e duke dhënë për njeri-tjetrin, e kjo quhet, marrëdhënie dashurie në kohë të plotë.



## **ANALIZA E SJELLJES SI DOMOSDOSHMËRI**

Elementet që forcojnë mendimin e adoleshentit janë pjesë e jetës së përditshme. Përçimi i tyre në ndjenjë, në vendimmarrje, në analizë, në vendime që përcaktojnë afate kohore, si dhe pëlqimi për çfarë zgjedhin, ndihmon dhe forcon shpirtin e tyre sipas kulturës ndërpersonale. Ky fakt ndihmon edhe në zgjidhjen e shumë problematikave, të cilat nuk duhet të anashkalohej, por duhet të bëhen të dukshme për të vetmen arsye: të shmangët përshkallëzimi i tyre, duke shprehur si anën pozitive të problemit, ashtu edhe anën negative të tij. Shmangia nuk ndihmon, përkundrazi, mund të tejkalojë kufij të përcaktuar më parë nga ana prindërore. Nuk luftojmë fëmijën adoleshent, por fenomenin që mbart brenda llojit të vet konflikti, i cili mund të bëhet edhe bartës i shumë problematikave që pasojnë në ditët në vazhdim.

Shmangia e problemit, ndikon në jetën e adoleshentit, jo sipas mënyrës që zgjedh prindi, por ndikon në atë formë, njëlloj si i mbyturi që kërkon shpëtim. Ujërat e problemit nuk të ngrenë në sipërfaqe, por të zhysin në thellësitë e tyre, e fëmija

nën vrullin e tyre, lufton me fuqitë e tij të pakta të shpëtojë, ndonjëherë edhe pa zë, pa gjeste e veprime, duke e lënë veten në duart e pasigurisë. Kjo zhytje nuk ndihmon shpirtin të luftojë, përkundrazi, e dobëson atë. Në këtë kohë shfaqen fenomene, të cilat vihen në dukje nëpërmjet anoreksisë, mbylljes në vetvete, shkëputjes nga jeta shoqërore, indiferencës ndaj mësimeve. Mungesat pa shkak në shkollë, janë sinjali ku prindi dhe mësuesi kuptojnë se diçka nuk shkon me fëmijën. Problemi fillon e thellohet kur nis kërkesa e llogarisë. Fëmija gjendet papritur në fund të thellësisë, e nga aty, ai kupton se nuk mund të ketë shpëtim për të. Kërkon frymëmarrje, por ajo mund t'i jepet vetëm e kushtëzuar, e në këtë gjendje, fëmijës i duhet të zgjedhë në kushte jonormale, pasi thellësia e shtrëngon fort me zinxhirët e saj të padukshëm. Kjo gjendje zgjat derisa fëmija fillon dhe jep shenja se po shkëputet i pafuqishëm nga kërkesa e llogarisë, e cila i ngjan me “dënimin me vdekje”. Ky dënim për të, është njëlloj si fryma e fundit që nxjerr për të lajmëruar fundin. Në këtë gjendje, prindit i del për detyrë bashkëpunimi me kohë të plotë me mësues e bashkëmoshatarë, për të ndërmarrë ndihmën e nevojshme që të kapërcejë situata, të cilat mund të çojnë në gjendje edhe më të rëndë në raport me atë që përshkruam më sipër. Situata ku gjendet fëmija mund të kapërcejë edhe kufijtë mendorë, ndaj ndihma në kohën e duhur, është vendimtare për fëmijën që rrezikon seriozisht.

Shfaqja e këtij fenomeni, evidenton më së miri atë çfarë prindi reflekton me sjelljen dhe vëmendjen e tij. Kjo situatë mund të anashkalohej, nëse prindi dhe fëmija bashkëpunojnë dhe bashkëveprojnë me njëri-tjetrin për çdo situatë dhe problem që ndeshin. Nuk është kurrë e tepërt t'i qëndrosh fëmijës pranë, edhe kur ai është i qetë dhe në dukje pa probleme. Komunikimi me të është urë që lidh mendimet dhe ndjenjat. Nëpërmjet komunikimit të ndërsjellë, kuptojmë dhe deshifrojmë mendimet e fëmijës tonë, e nëpërmjet tyre marrim informacion të nevojshëm dhe të bollshëm, se si duhet të sillemi dhe të veprojmë më tej me të.

Sistemi imunitar i fëmijës tonë, ndikon fort në shëndetin mendor të tij. Shëndeti mendor është ai që lajmëron pasoja të shëndetshme ose jo të shëndetshme. Të kujdesesh ditë pas dite për fëmijën në rritje, është detyrë mbi çdo detyrë prindërore. Sjellja e përditshme ndikon fort në shëndetin mendor të tij. Analiza e sjelljes, formon mendim të shëndetshëm që ushqen shpirtin e çdo fëmije adoleshent, për të përballuar ditët e jetës në vazhdim.

## PROBLEMATIKAT E ADOLESHENTËVE

Kur themi rritje në adoleshencë, nuk mund të kuptojmë vetëm shëndet, por edhe problematikë. Jo gjithmonë kërkojmë prej vetvetes, pasi problemet gjithmonë duam t'i vërejmë te të tjerët, e të tjerët janë ata me të cilët bashkëndajmë ditët e jetës. Në të vërtetë shfaqim probleme me njëri-tjetrin, vetëm kur ato bien ndesh me atë çfarë duam dhe pëlqejmë. Shpeshherë defektet ua faturojmë të tjerëve, miqve, shokëve, të afërmve. Janë ata që nuk kuptojnë sjelljen tonë, janë ata që nuk duan të mirën tonë, janë ata që na përqeshin për atë çfarë mendojmë etj., mendime që i mbjellim sipas unit tonë. Shkak i këtyre ndjenjave dhe mendimeve, bëhet dashuria për vetveten, e nëpërmjet kësaj dashurie të cunguar, jemi ne të parët që krijojmë probleme me sjelljen tonë të gjymtuar.

Shoqëria e sotme e ka shumë të zhvilluar unin e saj, e në këtë mënyrë, mbjellim pa kuptuar se nesër do të mbetemi duarbosh. Këtë un po e kultivojmë me dashjen tonë edhe te fëmija ynë, i cili rritet nën hijen e unit prindëror, për ta ruajtur nga gjoja ligësitë dhe xhelozitë, gjoja nga të këqijat e kësaj bote, por edhe duke e shfaqur në mënyrë krejt të pavullnetshme këtë

un, nëpërmjet fjalive dhe shprehjeve që nuk çojnë ujë në mullirin e edukimit shpirtëror sipas rregullave shoqërore, por në dëm të tyre.

Rregullat në shoqëri janë faktor tepër i rëndësishëm në mbarëvajtjen e shëndetshme shpirtërore të fëmijës adoleshent në rritje. Nuk mund të kuptojmë zbatim të rregullave shoqërore nëse vepron kundër tyre. Krijimi i unit në adoleshencë, përbën problematikë kur uni evidentohet në sjellje dhe në shfaqje mendimi, të cilat çojnë në ndarje shoqërore dhe krijimin e hendeqeve që kanë të bëjnë me marrëdhënie të ndërsjella. Por ndarjet bëhen më shumë të dukshme në kohën kur kërkohet bashkëpunim, e këtu ndalemi për të kuptuar rëndësinë e problemit që shfaqet mes adoleshentësh. Sado i vogël të shfaqet problemi i unit personal, ai vjen gjithmonë duke u rritur, e në kohën e rritjes shfaqen “gjemba”, që me majat e tyre shpojnë shpirtra njerëzorë. Këto shpime janë produkt i fjalës pa shije, i mendimit jobashkëveprues, i sjelljes me defekte të pakushtëzuara, i dashurisë së cunguar, e cila lëndon në atë formë, sa lë shenja plage, që nuk shërohen pa vetë dashurinë, e cila gjendet e hedhur tej pa arsyetim të shëndoshë. Në këtë gjendje uni kthehet në plagë shpirtërore, e cila ka nevojë për kurim, por pa u diagnostikuar si e tillë, mjekimi nuk jep efektin e shërimit.

Të konstatosh unin në shpirtin e adoleshentit, është punë specifike e prindit dhe e mësuesit. Por një prind që ka transmetuar unin e vet te fëmija i tij, nuk mund të

bëhet mjekim-shërimi për fëmijën e tij, përkundrazi, e përkeqëson situatën, ku fëmija gjendet pa dëshirën e tij. Kjo fazë ka zhvillimin e saj. Mësuesi luan rol tepër të rëndësishëm në këtë situatë, duke shpjeguar pasojat të rrezikshme që cenojnë seriozisht mirërritjen e fëmijës në vazhdim.

Uni bie ndesh me rregulla mirësjelljeje. Këto rregulla nuk janë vendosur nga dëshira prindërore, por bëhen të zbatueshme për të gjithë. Nuk mund të ketë sukses mësuesi pa bashkëpunuar me prindin. Të metat në sjellje, nxjerrin në pah seriozisht atë çfarë vetë prindi ka formuar me sjelljen e tij të fëmija, ndaj rezultati i frytshëm është edhe pasojë e një pune të frytshme. Por nëse nuk kuptojmë, se me sjelljen tonë dhe me veprimet e edukimit tonë mbjellim atë çfarë është e shëndetshme ose jo për mbarëvajtjen e fëmijës tonë, atëherë kemi mbjellë keq e nuk mund të korrim bollëk.

Është tepër e rëndësishme të kuptojmë, se analiza që i bëjmë veprimeve tona në lidhje me fëmijë, prindër dhe mësues, të mos kalojë cakun e edukimit të shëndetshëm shpirtëror dhe atë emocional. Emocionet krijohen kur analiza e sjelljes që reflektojmë, mbështetet fort në parime të shëndetshme dhe në marrëdhënie të shëndetshme. Gjithçka tjetër quhet abuzim me rregulla të edukimit dhe mirësjelljes fëmijë-prindër-mësues.

## **EFEKTI I PSIKOLOGUT TEK ADOLESHENTËT**

Çdo periudhë e jetës ka rëndësinë e vet, por ajo çka është më e rëndësishme për çdo prind, është periudha e rritjes së shëndetshme e fëmijës në familje që nga vegjëlia, e derisa prek moshën ku ndahet fëmijëria nga adoleshenca. Në këtë periudhë ndarjeje shfaqen simptomat e para të rritjes. Fëmija nuk qan më si fëmijë, nuk qesh më si fëmijë, nuk flet më si fëmijë, nuk diskuton më si fëmijë, e kështu me radhë, pasi shkëputja ndikon qoftë në zë, qoftë në buzëqeshje, qoftë në fjalë e gjeste, duke përcaktuar kështu, atë periudhë që kërkon vëmendje dhe përkushtim nga të gjithë pjesëtarët e familjes. Pikërisht kjo vëmendje dhe ky përkushtim, nuk mund të quhen detyrim me kusht, por analizohet për të nxjerrë detyra dhe rregulla në familje, që ndihmojnë, etapë pas etape, në mirërritjen e brezit më të ri.

Themi se kemi kohë të mjaftueshme për të kontrolluar fëmijën tonë, por shpesh e zëmë veten në grackën e këtij mendimi, kur ndeshemi me pamjaftueshmërinë e kësaj kohe. Jo gjithmonë gjendemi pranë fëmijës tonë, jo gjithmonë diskutojmë

me të, jo gjithmonë e përkrahim dhe e mbështesim kur ka nevojë. Kjo e metë që trashëgojmë si prindër, na bën të jemi deficitarë ndaj tyre.

Shumë herë tronditemi nga ngjarjet e kohës, por ende nuk kuptojmë, se shkaktarë të ngjarjeve që shohim e dëgjojmë, mund të jemi ndoshta edhe vetë ne një ditë, mund të jetë fëmija im, fëmija yt, fëmija jonë, pasi mëmësia dhe atësia, na bën të jemi bashkë brenda halleve dhe problemeve që vijnë e shkojnë në jetën tonë. Për të shmangur probleme qoftë të lehta apo të rënda, duhet të jemi vigjilentë ndaj shkakut, sado i madh apo i vogël qoftë ai, se vërtet fëmija lind i vogël, por rritet e bëhet i madh, ashtu edhe problemet lindin të vogla në fillim, por vijnë e zmadhohen, aq sa nuk mund t'i mbajmë më me shpatullat tona, e kështu nisim të kërkojmë ndihmën e psikologut, i cili merret me shkakun e fenomenit. Dikur familjet tona nuk e njihnin këtë lloj ndihme, por sot shkolla e ofron këtë ndihmë që ka dhe jep efektin e vet. Por, në fund të fundit, puna e psikologut është detyrë e njëjtë me atë të nënës dhe të babait, e çfarë lë mangët edukimi prindëror, plotësohet nga kjo ndihmë, e cila nuk mund të mohohet apo të anashkalohet. Kjo detyrë e rëndësishme nga ana e psikologut, ndikon dhe ndihmon në zgjidhjen e shumë problemeve, nëse kryhet me vullnet dhe dëshirë, për të përmbushur atë mision tepër të rëndësishëm për të cilin funksionon. Zëvendësimi i këtij lloj edukimi, në krahasim me fjalën e nënës dhe të babait, ka efektet e veta. Fëmija



ngjason si ajo pika e ujit mbi sipërfaqe në formën e flluskës, që mund të çahet papritur e të zhduket, ashtu dhe shpirti i fëmijës, prandaj nëse kjo ndihmë nuk jepet në nivelin e duhur mund të shkaktojë efektin e kundërt nga ai që presim.

Edukimi është pasqyrë e intelektit që prodhon në kohë fryte të begata. Pa këto fryte, shoqëria nuk mund të funksionojë brenda ligjeve dhe rregullave edukative. Ndaj përgjegjshmërinë nuk duhet ta shohim si koncept të përciptë, por në thellësi të tij, duke nxjerrë gjithsecili detyrën e vet, për t'u përfshirë në përgatitjen e brezit që do të trashëgojë kulturë dhe dinjitet.

## BASHKËVEPRIMI ME ADOLESHENTËT

Edukimi shpirtëror ndryshon nga ai shoqëror. Ndonjëherë kujdesemi për anën e dukshme, por harrojmë atë anë të padukshme, e cila është ajo e shpirtit të fëmijës tonë.

Të kalosh nga një gjendje në tjetrën, do të thotë të kapërcesh pengesa jo të lehta. Shpirti i fëmijës është i mbushur plot me sinjale, të cilat përçojnë gjendjen në të cilën ndodhet kudo qoftë ai, në mësim, në mjediset e shtëpisë apo në ato shoqërore. Si afër ashtu edhe larg tij, mund të kuptojmë shkaqe dhe arsye që e shoqërojnë fëmijën edhe pa praninë tonë. Nëse kjo ndjesi është mirëkultivuar në marrëdhënien prind-fëmijë, atëherë jemi të vetëdijshëm, se bashkëpunimi me të funksionon si afër apo larg tij. Këtu mund të ndalemi për të shpjeguar më me hollësi atë çfarë kam shpjeguar më lart.

Njëlloj si një varkë që nisat të vozisë, ashtu edhe shpirti i fëmijës tonë kur ndodhet larg familjes, vihet në provë për të përballuar ditën me të mirat dhe të këqijat e veta. Nga kjo pikëpamje, vërejmë se sjellja e fëmijës tonë duhet të reflektojë atë çfarë ne e këshillojmë dhe e drejtojmë kur gjendet vetëm, (njëlloj me varkën në

mes të detit). Lundrimi mund të jetë i qetë, por koha mund të prishet edhe pa pritur, ashtu edhe fëmija ynë, mund të kalojë një ditë të qetë, por mund të kalojë edhe një ditë me probleme që e trazojnë shpirtin e tij, e njëlloj si timonieri që di të përballojë dallgë të fuqishme, ashtu edhe shpirti i fëmijës tonë, duhet të jetë i përgatitur për të përballuar probleme qofshin të vogla apo të mëdha në mungesën tonë. Edukimi luan rol tepër të rëndësishëm në forcimin e shpirtit të tij. Nëpërmjet edukimit shmangen zënka e fyerje, përplasje me shokun apo shoqen, ofendime, të cilat përkeqësojnë situata të ndryshme, ku fëmija ynë gjendet papritur.

Të përgatisësh shpirtin e fëmijës për këto lloj situatash, është pasqyrë e edukimit prindëror dhe atij mësimor. Bashkëveprimi prind-mësues në këtë rast është jashtëzakonisht i vlefshëm, pasi nga ky bashkëveprim kuptojmë atë çfarë ka përfituar fëmija ynë, shmangie ose përkeqësim të problemit. Kur themi shmangie, kuptojmë qetësim të situatave konfliktuale, e kur themi përkeqësim të problemit, kuptojmë përfshirje ose ndikim shpirtëror me qëllim zmadhimin e problemit. Në këtë rast nuk kemi të bëjmë me vullnetin e fëmijës, por me edukimin që ai ka përthithur duke e reflektuar në sjelljen e tij. Kjo sjellje është produkt pa fryt, sepse të mos zgjidhësh në kohën e zgjidhjes, do të thotë papjekuri në kohën e edukimit. Nëse kjo papjekuri e fëmijës tonë ndikon negativisht edhe te shokët apo shoqet e tjera, atëherë

mësuesi bëhet rregullatori bazë që rregullon çdo situatë. Por nëse problemet nuk zgjidhen as nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje, atëherë vjen në ndihmë psikologu, i cili bëhet hallkë shtesë për të ndrequr e jo për të prishur. Të gjitha këto pika kyç, që influencojnë drejtpërdrejt në gjendjen shpirtërore të fëmijës tonë, kanë për detyrë të zgjedhin jo atë çfarë është më e lehtë për t'u zgjidhur, por atë çka është më e vështirë, pasi brenda thellësisë së problemit e jo në sipërfaqe të tij, do të gjejmë shkakun, i cili mund të fshihet nëse nuk jemi të zotë të punojmë me shpirtin e fëmijës tonë. Kjo punë nuk mund të mbetet përgjysmë, por me shkakun punohet në vazhdimësi, derisa të kuptojmë, se puna që kemi kryer në bashkim hallkash lidhëse me njëra-tjetrën, ka funksionuar duke vjelë produkt të shëndetshëm. Gjendja e fëmijës tonë na bën të kuptojmë nëse janë qetësuar ose jo situatat që fëmija ynë mund të ndeshë në ditët në vazhdim.

## **BOTA SHPIRTËRORE E ADOLESHENTËVE**

Arsyetimi i shëndoshëmbillet në saje të komunikimit. Të komunikosh mbi parime të shëndetshme, do të thotë të prekësh skajet e shpirtit. Gjuha e komunikimit është e ndërsjellë. Kjo gjuhë nuk mund të anashkalojë filozofinë e jetës, qëllimin përse kemi ardhur në jetë, jemi kalimtarë të rastësishëm, apo kemi një mision për të përçuar me qenien tonë.

Në rrugëtimin e fëmijës tonë, drejt aspiratave që ai kërkon të realizojë dhe të arrijë në jetë, ndër më të rëndësishmet është që fëmija ynë duhet të kuptojë ekzistencën e tij. Jo rastësisht ka ardhur në jetë, jo rastësisht frymon në këtë jetë. Kjo pjesë shumë e rëndësishme e edukimit të tij të mirëfilltë, ka të bëjë me kulturën prindërore dhe me atë të mësimdhënies. Kuptimi i rëndësisë së ekzistencës është kusht themelor, për zgjidhjen e shumë problemeve dhe dinamikave që zhvillohen në jetën e fëmijës tonë. Çdo problematikë është e zgjidhshme, kur kuptojmë dhe përvetësojmë atë çfarë është më e rëndësishme në qenien tonë, marrëdhënien e dashurisë mes njëri-tjetrit. Nëse kjo marrëdhënie nuk kuptohet në

ekzistencën e saj, atëherë vështirësia është shkak dhe pasojë në përkeqësimin e gjendjes shpirtërore të fëmijës tonë.

Mungesa e konceptit të dashurisë në jetën e fëmijës, bëhet shkak i shumë problematikave, të cilat nuk mund të anashkalohen pa e prekur këtë edukim, i cili anashkalohet jo pak nga prindër dhe mësues. Të priresh drejt botës së interesit individual, është gabim jo i vogël gjatë periudhës së edukimit shpirtëror dhe atij moral të fëmijës. Bota e interesit është mjaft e vogël në krahasim me atë të dashurisë. Por kjo botë e vogël sa vjen e po zmadhohet brenda shpirtit të fëmijës tonë. Kjo botë bëhet shkak konflikti interesash, të cilat shfaqen në botën krijuese të shpirtit të fëmijës, duke sjellë pasoja të rënda në mirëritjen e tyre. Krahasimisht, interes dhe dashuri nuk shkojnë me njëra-tjetrën, e kjo pabarazi sjell lëkundje të forta në psikikën e fëmijës tonë. Është më bukur të duash pa e përfshirë interesin, sesa të ngatërrosh dy botëkuptime të ndryshme. Interesi shfaqet në sjellje, në veprime që pasojnë njëra-tjetrën, qoftë në marrëdhënie, qoftë në botëkuptim.

Fëmija adoleshent është në fazë rritjeje, e kjo fazë e ndan, por edhe e bashkon. Ajo çka duhet ndarë është falsiteti në sjellje, është egoizmi në të shprehur, është shfaqja e fenomenit interes në marrëdhënie sinqeriteti, të cilat formojnë një botë ku nuk jep, por kërkon vetëm të marrësh atë që nuk është e vërtetë dhe e drejtë. Nëse bota e interesit përfshin sjellje, që bien ndesh me

konceptin e dashurisë së ndërsjellë, atëherë problemet që lindin mes fëmijësh adoleshentë, agravohen dhe sjellin për pasojë ndarje. Këto ndarje reflektojnë armiqësi jo në sipërfaqe të sjelljes, por në brendësi të tyre. Shpirti i adoleshentit përpunon të dhëna në kohë rekord, por marrja e këtyre të dhënave dorëzohet vetëm në serverin qendror të trurit të fëmijës, atje ku grumbullohet gjithçka që fëmija kërkon prej vetes dhe të tjerëve. Të gjitha këto të dhëna, reflektojnë sjellje të ndryshme, që nga ato më të sinqertat, e deri tek ato manipulative. Në këtë qendër grumbullimi informacioni, fëmija fillon të zgjedhë sipas dëshirës dhe vullnetit të tij mendor edukativ. Vullneti i fëmijës në të zgjedhur, karakterizon atë anë pozitive të tij, duke ndarë të mirën nga e keqja.

Fëmija adoleshent ndien nevojë të theksuar për dashuri, e këtë dashuri e kërkon edhe në vështirësi, ku mund të gjendet pa vullnetin e tij. Dashuria e munguar e bën agresiv, e bën të mos arsyetojë në mënyrë të shëndetshme, të mos këshillohet me prindër apo mësues, të anashkalojë shoqërimin me bashkëmoshatarë. Shpirti i tij lufton si luftëtari në betejë për të mos humbur në vorbullën e ndjenjave që luftojnë me njëra-tjetrën.

Çdo prind duhet ta kuptojë gjendjen e fëmijës kur ai reflekton këto trazira në sjellje. Kjo gjendje nuk mund të anashkalohe duke u marrë përceptas me të, por prania e prindit pa e gjykuar sjelljen e tij, bën që shpirti i tij të qetësohet nga një fjalë e ëmbël, nga

një përqaftim i dhënë plot dashuri, nga një këshillë e mjalhtëzuar. Fëmija ynë ka shumë nevojë për këtë përkrahje, për këtë moment kaq të rëndësishëm në gjendjen ku ndodhet. Jo të gjithë dinë të dhurojnë dashuri, jo të gjithë dinë të këshillojnë me dashuri, jo të gjithë dinë të përqafojnë me dashuri, por kjo mungesë në kulturë sjelljeje, krijon imazhe ku fëmija formon brenda botës së tij, atë që percepton me konceptin e pasigurisë.

Ta ndiesh dashurinë deri në qelizë, është virtyt shpirtëror. Kur ndien edhe dhuron. Ndjeshmëria është pasqyrë e shpirtit që rrezaton dashuri, e në mungesë të kësaj ndjeshmërie, jemi dhe bëhemi problematikë si për veten, ashtu edhe për fëmijën tonë. Sjellja prindërore shpeshherë nuk prodhon këtë lloj ndjeshmërie, por kërkesë llogarie. Brenda kërkesës së llogarisë, shpeshherë futemi në grackën e kënaqësisë për vetveten, sepse vetvetja nuk na lë të shohim përtej logjikës dhe mendimit tonë. Ky lloj funksionimi nuk është frytdhënës, por krijon deficite që formojnë boshllëqe, të cilat nuk mund të mbushen. Shpirti i zbrazur i një fëmije adoleshent nga mungesa e dashurisë, është tokë e thatë ku nuk mbjell dot asgjë të bukur. Fëmijët, që rriten pa dashurinë dhe fjalën e ngrohtë të prindit apo mësuesit, bëhen produkt i mangësive të asaj çka vlen më shumë, dashurisë, që dhurohet falas dhe jepet falas nga të gjithë.



## **PASOJAT E LËNDIMIT TË ADOLESHENTIT NGA MËSUESI**

Vendet ku zhvillohet mësimi quhen vatra të dijes. Këtu fëmija zhvillohet dhe përgatitet të ecë i sigurt në udhët e jetës. Kjo udhë përcakton edhe zhvillimin e tij të mëtejshëm në rrugën e dijes. Shkolla është familja e dytë për fëmijën tonë. Transferimi i kërkesës së llogarisë nga familja te shkolla, quhet ndërmarrje e ndarë në sektorë progresivë. Në këta sektorë përfshihen mësues të kategorive të ndryshme, me të cilët fëmija do të krijojë kontakte. Ky ndryshim duhet t'i paraprijë sigurisë së tij shpirtërore, në të kundërt, efektet negative krijojnë shpërqendrim dhe pasiguri.

Gjendja shpirtërore e fëmijës për mësuesit e kategorive të ndryshme, duhet të bëhet moto dhe qëllim i punës së tyre, pasi shëndeti mendor është kusht themelor-bazë për ngritjen dhe standardin edukativ. Edukimi është forma më e lartë e punës së palodhur të një mësuesi. Nëpërmjet edukimit, shpaloset varfëria ose pasuria shpirtërore e një mësuesi impenjativ në marrëdhënie me nxënësit. Kur themi impenjativ, nënkuptojmë atë prodhim me bollëk që sjell rezultate pozitive të punës së mësuesisë. Megjithatë jo

gjithmonë punët na shkojnë ashtu si duhet. Ndodh që hasim në ato pengesa dhe vështirësi, ku fjala mësues e ndryshon kuptimin e saj. Respekti ndaj mësuesit nuk duhet të mungojë, por gjithashtu është tepër e domosdoshme, që edhe respekti ndaj nxënësit adoleshent askurrë nuk duhet të mungojë, por të vihet në dukje sipas rrethanave të mësimdhënies. Nëse një mësues lëvdon një nxënës për rezultate të mira në përgatitje, është shtysë për rezultate akoma edhe më të frytshme. Por nëse një mësues e anashkalon këtë rol kaq të rëndësishëm, atëherë edhe konfliktet shpirtërore nuk mungojnë të vijnë. Kemi shumë raste ku shfaqen këto konflikte, kemi shumë raste ku mësues të lëndëve të ndryshme, kanë mangësi në këtë drejtim. Por nuk është vetëm ky problemi. Pasojat përshkallëzohen në forma të ndryshme. Mangësitë në sjelljen e mësuesit nuk përcjellin mesazh fitimprurës shpirtëror. Shpirti i fëmijës është shumë delikat, e për pasojë, lëndimi është goditje që lë gjurmë. Nxënës të pakënaqur nga sjellja e mësuesit, shprehin pakënaqësi që duhet të evidentohen e jo të anashkalojnë.

Frika është element që zbraz shpirtin. Nxënës, që frikësohen për të nxjerrë në dukje të vërtetën e lëndimit, nuk mund të përballojnë shëndetshëm orët e mësimin. Në gjendjen e frikës dhe të lëndimit, nuk prodhohet shëndet mendor dhe pasojat e këtij shëndeti bëhen të dukshme nëpërmjet sjelljes së fëmijës.

Në këtë rrugëtim të përbashkët do të ndeshim mësues që katapultojnë gabimet e sjelljes së tyre

duke ua faturuar nxënësve. Por mjaft e rëndësishme është të kuptojmë, se pa u vënë në dukje pa frikë këto gabime, nuk mund të quhemi shoqëri e shëndetshme që edukojmë nxënës dhe fëmijë të shëndetshëm. Nëse një mësues shfrytëzon rezultatin nëpërmjet notës për të ushtruar pozitën e tij ndaj fëmijës-nxënës, atëherë kambana e alarmit duhet të buçasë fort, për t'u dëgjuar edhe nga ata që bëjnë sikur nuk dëgjojnë. Frika nuk mund të shpjegohet me terma jokonkretë. Mësimdhënia nuk është trampolinë, ku mësues të papërgjegjshëm katapultojnë sjellje jo brenda moralit njerëzor, por për hakmarrje apo për interesa personale.

Nëse një mësues bëhet bartës i ankesave të nxënësve adoleshentë, atëherë së bashku nxënës dhe mësues duhet të bëhen faktor i patjetërsueshëm për të vënë në pah dëmin shpirtëror dhe mendor të fëmijës tonë në rast padrejtësie nga mësuesi.

## MARRËDHËNIET PRIND-FËMIJË

Bota ku lundrojnë pasionet e fëmijës adoleshent, përmban dhe përmbledh deri në gjuhën e misterit një lumë informacionesh. Veçori dalluese e tyre është të kapërcesh mendimin njerëzor. Le të ndalim në këtë konkluzion, sepse dëshira dhe realizimi i tyre kapërcejnë kufij pa ndalesa, që do të thotë: edhe pse s'e njëh rrezikun adoleshenti kërkon dhe dëshiron pa llogaritur atë çfarë i përket ose jo. Informacionet që përthithin fëmijët adoleshentë ngjajnë me fluturat e livadheve, kërkojnë të kapin çdo flutur krahëshkuar, kërkojnë të zotërojnë të bukurën, të mistershmen, të depërtojnë edhe atje ku nuk hapen portat, të luftojnë për t'u bërë heronj të ngjarjeve të mëdha, të shpikin ide dhe falë këtyre informacioneve kërkojnë të realizojnë pa e njohur rrezikun.

Idetë në adoleshencë kanë formën e një globi të ndarë në pjesë të ndryshme, në dëshira dhe qëllime, por të duash dhe të realizosh, nuk është e njëjta gjë, por krejt të kundërta nga njëra-tjetra. Në dëshirë dallojmë se ndjenja mbizotëron kundër arsyesimit, por të realizosh atë çfarë dëshiron është krejt e kundërta e dëshirës që nxitet nga ndjenja. Kemi përplasje, kur

vetë fëmija nxit të afërm apo bashkëmoshatarë, për t'i bërë pjesë të këtyre iniciativave që ndërmerr. Këtu ndalemi për të kuptuar.

Jo pak herë shqetësohemi nga sjellja e çuditshme e fëmijës tonë, jo pak herë e kritikojmë për veprime, të cilat nuk na pëlqejnë. Rezistenca e fëmijës për të mbajtur të fshehtë atë çfarë na shqetëson, bëhet mur i pakapërcyeshëm, nëse nuk tregohemi vigjilentë dhe të durueshëm me të. Arsyeja që na shtyn për të mësuar gjithçka rreth sjelljes së fëmijës tonë, është misteri që rrethon veprimet e tij. Ky mister mund të ngrijë marrëdhëniet prindër-fëmijë. Në këtë kohë hyn në punë kërkesa e llogarisë, e cila bëhet urë lidhëse, për të gjetur çelësin e portës së misterit. Nëpërmjet kërkesës së llogarisë, mund të kuptojmë çfarë lloj rezistence përdor fëmija ynë adoleshent duke u fshehur brenda saj. Kërkesa e llogarisë nuk është kurrë e tepërt në këtë rast. Çelësi që kemi në duar si prindër, na siguron se mund të depërtojmë nëpërmjet bisedës me fëmijën tonë, për të kuptuar dhe për të marrë atë çfarë na shqetëson.

Fëmija adoleshent është i prirë të ruajë sekrete, të cilat mund t'i ndajë vetëm me ata që ka më pranë; shok, shoqe, ose ndonjë i afërm familjar. Jo shpeshherë fëmija zgjedh prindin për t'i treguar të fshehtat e tij si një shok apo shoqe. Muri që ngremë në marrëdhënien me fëmijën tonë adoleshent, mbi të gjitha është kërkesa e llogarisë. Jo gjithmonë duhet të jemi kërkuar, por shumë herë duhet të jemi

bashkëpunues. Nëse sigurohemi që këto të fshehta të tij nuk përbëjnë problem shqetësues, atëherë mund të vazhdojmë të jemi vigjilentë ndaj sjelljes së tyre. Por nëse këto të fshehta kanë të bëjnë me moralin e fëmijës tonë, atëherë kambana e alarmit nuk pushon së rëni. Gjithçka fillon të rrotullohet rreth kujdesit ndaj fëmijës tonë. Asgjë tjetër nuk mund të zërë kohën që i duhet kushtuar atij. Vëmendja dhe përqendrimi ndaj sjelljes së tij përmbushin ditën. Nëse fëmija ynë kërcënohet nga rreziku, atëherë bashkëpunimi me të nëpërmjet bisedave të ekuilibruara, kontrollit mbi veprimet që ai kryen, kontrollit me kë shoqërohet, kontrollit mbi ecurinë e mësimeve, bëhen metodë ku punohet jo për të prishur marrëdhënien me të, por për të ndihmuar në kapërcimin e situatave të vështira ku mund të gjendemi papritur.

Të ushqesh shpirtin e një fëmije adoleshent me dashuri dhe me drejtësinë e saj, është punë me kohë të plotë. Shpirti i fëmijës trazohet lehtë. Shkak i këtij trazimi bëhet pasiguria e tij për t'u bërë ballë problemeve që ndesh për faj të tij ose e kundërta. Është tepër e rëndësishme që fëmija ynë të ushqehet ditë pas dite me ndjenjën e dashurisë dhe të drejtësisë së saj. Ky ushqim është i mjaftueshëm për të rregulluar sistemin e tij imunitar, ndaj padrejtësive që bëhen shkak shpërqendrimi.

Nëse do të kuptojmë si prindër rëndësinë e këtij ushqimi, i cili nuk blihet, por dhurohet, atëherë kemi në duar çelësin që hap portën e shpirtit të fëmijës tonë.

Jo të gjithë prindërit i ushqejnë fëmijët me dozën e dashurisë dhe të drejtësisë së saj. Dhe nëse mungon ky ushqim shpirtëror, atëherë problemet bëhen evidente dhe të pakthyeshme për të gjitha ato familje që nuk e njohin këtë ushqim.

## **TË MIRAT DHE DËMET E TEKNOLOGJISË**

Jeta e një adoleshenti është si një vorbull që thith e tërheq drejt vetes gjithçka që e rrethon. Jemi të vetëdijshëm se ana emocionale e tij është ndjeshmëria, pa të cilën nuk do të kuptohej kjo moshë. Aspekti emocional ndikon tepër në sjelljen e tyre, pasi kjo moshë është e prirë të shpërthejë kur bëhet fjalë për sjelljen e tyre, tek bie ndesh me atë çfarë i kërkohet të realizojë. Nuk jemi indiferentë ndaj këtyre shpërthimeve, por jemi të pranishëm kur ato bëhen të pranishme. Kjo moshë, për sa i përket zhvillimeve të vrullshme të kohës që po jetojmë, ka ndjeshmëri tepër të lartë ndaj fenomeneve, duke përmendur kështu aspektin e zhvillimit teknologjik. Jo gjithmonë ndeshim në produktivitet, e jo gjithmonë teknologjia është shërbyese e mirë e shpirtit të fëmijës tonë. Por le t'i marrim gjërat me radhë. Ndihma që na vjen nga teknologjia është si ajo shërbyesja e mirë e shtëpisë (shpirtit tonë). Nëse një shërbyese rregullon pa prishur, atëherë jemi të shpërblyer për çfarë paguajmë, por nëse kjo shërbyese edhe prish edhe ndreq, atëherë edhe shtëpia jonë do të jetë e



trazuar nga ky shërbim. Kështu ndodh edhe në rastin e teknologjisë së zhvilluar që hyn në jetën dhe në shpirtin tonë.

Problemet që na shqetësojnë janë me shumicë, e një mori prej tyre na vijnë nga kjo shërbyese teknologji, e cila na i bën rrëmujë punët e shtëpisë, e për t'i ndrequr na duhet t'i hyjmë punëve nga e para. Nuk e përzëmë dot nga shtëpia, por na duhet të bashkëjetojmë me të. Nevoja për shërbimin e saj, edhe na duhet, edhe nuk na duhet, e për të ndarë çfarë është mirë e çfarë është keq nga kjo zonjë shërbyese, që hyn e nuk del nga jetët tona, duhet të vëmë në punë dhe në funksion boshtin e jetës, në mënyrë që edhe këtë shërbëtoare teknologji, ta vëmë të punojë vetëm për të mirën e shtëpisë-familjes sonë. Por që të ndajmë të mirat dhe të këqijat që na vijnë nga teknologjia, do të na duhej një pushim me kohë të plotë për t'u shkëputur prej saj. Në këtë mënyrë do të krijonim bindjen se çfarë na duhet dhe jo prej fryteve të saj. Në këtë mënyrë do të shkëputeshim prej informacioneve që nuk na vlejné, por që përkundrazi, kanë dëmtuar dhe dëmtojnë seriozisht mirëqenien dhe të ardhmen e fëmijëve tanë.

Informacionet e dëmshme, që burojnë nga zhvillimi teknologjik, janë viruse, që shkaktojnë sëmundje psikologjike të pariparueshme në jetën e çdo fëmije, kudo ku hyn zhvillimi teknologjik. Çdo fëmijë që mban një armë të tillë teknologjike në duar, është i destinuar t'i nënshtrohet kësaj sëmundjeje tepër të rrezikshme, e cila po zëvendëson edukimin

me informacionin. Nuk ndodh të jemi të shëndetshëm prej këtyre informacioneve të rrezikshme, të cilat nuk e rrisin inteligjencën e fëmijëve tanë, përkundrazi, e dobësojnë së tepërmi atë, duke ulur shkallën e zhvillimit të tyre mendor në rrugë natyrale. Kjo bëhet e dukshme te çdo fëmijë që anashkalon bisedën me shokun apo shoqen, duke e kanalizuar atë drejt kësaj arme teknologjike, duke e kaluar kohën nën shoqërinë e saj. Kjo sëmundje, që mund ta quajmë gjigante, është shfaqur prej teknologjisë dhe ndikon seriozisht në marrëdhëniet me prindër, me mësues dhe bashkëmoshatarë. Shpërndarja e informacioneve të panevojshme për moshën e një adoleshenti nëpërmjet rrugës së teknologjisë, është problemi më i madh me të cilin mund të ndeshet sot një prind apo një mësues.

Zhvillimi përkufizon rritje të aspiratave, të qëllimeve dhe ideve njerëzore. Por nëse këto arritje çojnë në dëm të zhvillimit dhe të mirëqenies njerëzore, atëherë mbarë shoqëria duhet të jetë e përgatitur për të luftuar çdo të keqe që i bën dëm shoqërisë që pretendon se jeton në kohën e zhvillimit teknologjik. E keqja na vjen nga vetja jonë, sepse jemi ne vetë që pranojmë ose nuk pranojmë të hyjë apo të dalë nga shtëpia jonë hajduti-vjedhës. Nëse nuk e ruajmë jetën tonë nga ky vjedhës, atëherë shumë shpejt, rezultatet do t'i shohim në trashëgimin e brezave që po përgatisim në jetë.

Me zhvillimin e teknologjisë marrin përparësi edhe metodat mësimore. Në jetën e adoleshentit rriten

edhe kërkesat e tyre impenjative. Te nxënësit, që kanë përparësi rezultatin në mësim, vendosen edhe kushte që të shpien drejt këtij rezultati, ku në ndihmë vjen teknologjia dhe format e saj, të cilat japin ndihmesë të konsiderueshme. Por jo çdo informim nga kjo teknologji është në të mirën e fëmijëve tanë, jo çdo informacion ndihmon në rezultatin që duam apo e quajmë të merituar.

Nëse e krahasojmë fushën e emocioneve natyrale me ato që na ofron teknologjia, do të ndeshim me një raport jo të kënaqshëm nga ai që presim. Emocioni natyral ndryshon nga ai virtual. Fusha e virtualitetit, është ajo hapësirë ku prodhohen impulse të diktuar jo nga ndjenja njerëzore. Kjo fushë ofron shumë mundësi komunikimi, por jo atë të traditës së komunikimit njerëzor. Në mungesë të komunikimit njerëzor na ofrohet komunikimi virtual, i cili e mund ndjenjën në bukurinë e dhurimit të saj. Ndjenja përfitohet nëpërmjet takimit, prekjes, përqafimit, e nëse e mposhtim këtë ndjenjë duke e sofistikuar me mjete teknologjike, atëherë kemi filluar të luftojmë shpirtin njerëzor. Së pari në këtë luftë goditet ndjenja, e më pas goditen me radhë të gjitha shqisat njerëzore. Shikimi e humbet bukurinë e tij, dëgjimi po ashtu ndesh në vështirësi komunikimi me realen dhe natyralen.

Të zëvendësosh prekjen me gjuhën e teknologjisë, është falsiteti më i shëmtuar që i ofrohet qenieve njerëzore si gjoja metodë lehtësimi në jetën e tyre.

Por jeta e një adoleshenti nuk mund të funksionojë në natyrshmërinë e vet, pa bukurinë e emocioneve të prekjes, të vështrimit, të komunikimit njerëzor në afrimet dhe në bashkim ndjenjash.

Lufta sot zhvillohet për të fituar territor, e ndërsa teknologjia po merr zhvillim marramendës, njerëzimi duhet të kuptojë se brezi i ri po shkon drejt falimentimit shpirtëror. Nuk mund të zëvendësohet realiteti me virtualitetin, nuk mund të zëvendësohet komunikimi njerëzor me atë teknologjik. Kjo shpërbërje të çon në degradimin e edukimit shpirtëror dhe atij mendor të të rinjve tanë. E theksoj, se ndihmesa e teknologjisë është e nevojshme vetëm atëherë, kur i shërben njeriut për nevojat e tij, pa i vënë barriera në zhvillimin e tij në rrugë natyrale drejt mirëqenies shpirtërore. Çdo arsyetim tjetër, që të shpie drejt kundërshtimit të këtij përkufizimi, është teori që nuk ndihmon në përparimin e edukimit të brezit më të ri.

Të zëvendësosh gjuhën njerëzore me atë teknologjike, është faliment i inteligjencës njerëzore. Inteligjenca njerëzore i shërben edukimit dhe jo falimentimit edukativ të njeriut. Pasuria e informacioneve, që gjenden brenda gjuhës së teknologjisë, është një lloj me përzierjen e grurit me egjërën, por që nuk mund të quhet ushqim i pastër për shëndetin e shpirtit njerëzor.

Kultura që përfitohet nga metodikat e sistemit arsimor nuk gjendet në rrjetet sociale, në të cilat fëmija ynë informohet ndoshta më shumë sesa në vetë procesin mësimor. Të përdorësh në formimin

e kulturës së fëmijës dy metoda të ndryshme, është përgjegjësi absolute e një sistemi të tërë drejtues. Ky sistem ka në varësi të tij një linjë të gjerë institucionesh, të cilat pretendojnë forma edukimi dhe mirërritje. Por çfarë përfitojmë prej këtij lumi informacionesh në zhvillimin e fëmijës tonë? Është pyetje që mund t'i bëhet çdo prindi, por edhe çdo fëmije adoleshent.

Nëse dëshirojmë më të mirën për zhvillimin kulturor dhe arsimor të fëmijës tonë, atëherë do të zgjedhim më të mirën për të. Por cila është e mira më e madhe e tij? Në këtë mënyrë zgjedhja kthehet në qëllim. Por cili është qëllimi ynë kur zgjedhim? Është vendimmarrja në kohën e duhur. Por cila është koha e duhur? Është ajo sot, ku e tashmja rrezikon të humbasë dhe e ardhmja mund të fshihet. Përzierja e kulturave të ndryshme shkakton trazime, të cilat prekin shqisat dhe ndjenjat e fëmijës, duke i përplasur me njëra-tjetrën në luftë për të fituar terren mbi dijen. Dija e cunguar apo e keqformuar është armiku më i madh i edukimit shpirtëror të fëmijës adoleshent. Nuk mund të pretendojmë, se nëpërmjet përzierjes së kulturës së dijes përfitojmë më të mirën. Rrjetet sociale kanë marrë përparësi në jetën e fëmijëve adoleshentë, duke formuar kështu brenda botës së tij atë që quhet: privatësi e paprekshme. Kjo lloj privatësie është kthyer në armik të padukshëm që lufton mirëqenien e vetë fëmijës tonë.

Kultura e rrjeteve sociale nuk shërben për atë çfarë kemi nevojë më shumë, përkundrazi, lufton

vazhdimisht duke na kthyer në qenie kompjuterike, në mënyrë që të mendojmë, të komunikojmë, të ndiejmë vazhdimisht sipas gjuhës dhe kulturës së saj. Të menduarit në mënyrë autodidakte, nuk është shpresë për zhvillimin e trurit të fëmijës tonë. Të vepruarit në mënyrë patologjike, nuk është mënyra më e mirë e zhvillimit të ndjenjave të fëmijës tonë. Të shijuarit në mënyrë virtuale për fëmijën tonë, nuk është mënyra më e mirë për të fuqizuar ndjenjat e fëmijës tonë. Kjo botë virtualiteti, është si ai vullkani që mund të shpërthejë papritur, duke shkaktuar kaos në edukim dhe në kulturë, duke sjellë falimentim në mirëqenien shpirtërore dhe atë edukative të fëmijëve tanë.

Nëse e konceptojmë jetën e një adoleshenti në bazë të zhvillimeve teknologjike dhe jo në bazë të zhvillimeve natyrale të drejtpërdrejta, atëherë me dëshirën tonë po krijojmë burgun tonë, çelësin e të cilit e ka në duar teknologjia dhe format e saj. Ky burg të privon nga liria, tek e cila formohet ndjenja, dëshira, vullneti, pasioni, aq të nevojshme për t'u shijuar pa konceptin e virtualitetit. Ky koncept është dëmi më i madh që po injektohet në fazën e rritjes të çdo fëmije, duke cenuar kështu seriozisht ekzistencën tonë si qenie të lira.

Detyra e çdo prindi, e çdo mësuesi dhe e çdo bashkëqytetari, është të kundërshtojë hapur këtë formim imponues, duke e reklamuar ditë pas dite si mjetin më të panevojshëm për formimin e botës shpirtërore të fëmijëve tanë. Por të bashkëpunosh për

një kauzë kaq të rëndësishme dhe jetike, duhet forcë dhe bashkëpunim, që nga instancat më të larta e deri te baza, sepse mirërritja e fëmijëve tanë është detyrë e përbashkët me qëllim të përbashkët. Angazhimi dhe bashkëpunimi sjell fryte vetëm atëherë, kur duhet të kuptojmë se jemi qenie të lira dhe jo të varura. Në liri të plotë shpirtërore japim dhe marrim atë çka është më e mirë nga vetja jonë.

## **DASHURIA ËSHTË ARMA QË FITON ÇDO BETEJË**

Në literaturën bashkëkohore kemi studiuar rolin interpretativ të shumë analistëve psikologë, ku theksohet ndërgjegjësimi i prindit në kulturën e mirërritjes së fëmijëve sipas standardit bashkëkohor. Të rrisësh një fëmijë sipas kushteve aktuale, do të thotë t'i nënshtrohesh edukimit të atij lloj standardi, i cili imponohet nëpërmjet progresit kohor. Por, në të vërtetë, nuk mund të marrim hua për të mirërritur fëmijën tonë, pasi huaja nuk është tullë që vendoset në themelet e shtëpisë sate. Ndërgjegjësimi i edukimit të fëmijës, është detyrë dhe njëkohësisht impenjim i pakthyesëm për të arritur rezultate fitimprurëse në mbarëvajtjen e jetës në familje.

Kushtet ku ne jetojmë ofrojnë shumë mundësi edukimi, nisur që nga shkolla, institucionet e ndryshme që fëmija frekuenton për të ndihmuar lëndët mësimore, mjedise sportive etj. Por është shumë e rëndësishme të theksojmë, se kudo ku fëmija ynë prek, vëzhgon, ndërmerr veprime, duhet të jetë në kontakt me moralin njerëzor. Ky kusht i patjetërsueshëm dhe i panegociueshëm me asnjë edukim tjetër, bën



që edukimi të japë fryte për shëndetin mendor dhe shpirtëror të fëmijës tonë.

Në moshën e adoleshencës, edukimi me bazë moralin është një nga problemet më të ndërlikuara që hasim. Morali është toka ku punohet pa frikën se nuk do të korrësh prodhim të begatë. Familjet tona kanë pasur dhe kanë traditë moralin njerëzor, tek i cili fëmija gjen gjithçka i duhet për të ecur përpara në jetë. Brenda moralit edukojmë virtyte njerëzore, për të cilat kemi nevojë të gjithë për t'u forcuar shpirtërisht dhe mendërisht. Fëmija ynë ka shumë nevojë për dashurinë tonë, të cilën nuk mund t'ia dhurojmë të cunguar apo të gjymtuar. Një dashuri e gjymtuar është me pasoja të rënda për fëmijën. Kjo lloj dashurie simbolizon njeriun pa një dorë ose pa një këmbë, e kështu punët quhen të pambaruara në tokën e shpirtit.

Familjet, që e ndajnë dashurinë në dy pjesë, kur nuk funksionon jeta bashkëshortore, prodhojnë efekte anësore brenda shpirtit të fëmijës. Por më e rëndësishme është kjo pasojë në adoleshencën e këtyre fëmijëve, pasi nevoja për dashuri me kohë të plotë dhe jo të pjesshme, e bën fëmijën të prodhojë edhe efektet që merr nga kjo mungesë.

Nëse e gënjejmë veten se gjithçka shkon mirë, meqë fëmija i ka të dy prindërit, por me kohë të pjesshme, atëherë formula njerëzore që kemi zgjedhur për të prodhuar dashuri, është me simbole të panjohura për fëmijën tonë. Këto simbole përkufizojnë dëmin që

merr forma të ndryshme në mendjen dhe në shpirtin e fëmijës. Dëmi përhapet në formë të dukshme dhe të padukshme, duke formuar kështu ndjenjë zemërimi, hakmarrje, mbyllje në vetvete, egoizmi, kryeneçësie, me të cilat fëmija qëllon në heshtje herë njërin prind dhe herë tjetrin. Gjuha e kësaj heshtjeje mund të kthehet në kërcënim serioz për edukimin e fëmijës. Në të shumtën e rasteve kemi fëmijë që pasojë kanë inatin, i cili kultivohet thellësisht nga lloji i ndarjes së dy prindërve. Nëse shkak është tradhtia, atëherë guri me të cilin fëmija qëllon prindin shpirtërisht është indiferenca ndaj fjalëve edukuese që ai përdor. Kjo lloj indiference është hakmarrje jo e fshehtë, por ballë për ballë. Në këtë rast fëmija përdor largimin, mënjanimin dhe duket moskokëçarës ndaj problemeve në familje, pasi lëndimi që ka pësuar nëpërmjet tradhtisë së prindit e bën të pasigurt për çfarë do të ndodhë me jetën e tij në vazhdim.

Jemi të ndërgjegjshëm se çdo pasojë që i faturojmë fëmijës me sjelljen dhe veprimet prindërore, do të marrim edhe reston, e kjo resto na bën të mendojmë si prindër, të cilëve na është bërë një dhuratë tepër e çmuar, të lindim dhe të rrisim fëmijë të shëndetshëm. Por shëndeti i fëmijës tonë nuk është vetëm ushqyerja e barkut, por është tepër e rëndësishme për të kuptuar, se shëndeti shpirtëror i fëmijës tonë, mbi të gjitha në moshën e adoleshencës, është detyra më e rëndësishme që e karakterizon çdo prind. Kjo përgjegjësi dhe kjo dashuri e madhe për këtë qenie njerëzore, të ngjizur